VENDIM
Nr.74, datë 2.11.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT, PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR SHOQËRINË "AMAL" SHPK, PËR VITIN 2007

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshime, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Amal" sh.p.k, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për shoqërinë "Amal" sh.p.k., për vitin 2007.
2. Ngarkohen Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga "Amal" sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2007.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta